



Komuna e Podujevës
Opština Podujevo
Municipality of Podujeva

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 07-04-2026		
Njësi.org. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-046	101-0020	926/26
PODUJEVË - PODUJEVO		



Shoqata
Jetimat e Ballkanit

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

BASHKËFINANCIM TË NDËRTIMIT TË SHTËPIVE FAMILJEVE NË NEVOJË

e lidhur ndërmjet

KOMUNA E PODUJEVËS,

me seli në Podujevë, rr. "Nuhi Gashi" nr.49, e përfaqësuar nga Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)

Dhe

SHOQATËS BAMIRËSE "JETIMAT E BALLKANIT",

me seli në Prizren, rr. "Bekim Muhaxheri" nr.18, të cilën e përfaqëson Berat Kabashi, Drejtor i Shoqatës (në tekstin e mëtejme Shoqata)

I

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i lidhjes së kësaj Marrëveshje është pajtueshmëria për bashkëfinancim dhe angazhim të ndërsjellët të Komunës së Podujevës dhe Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” për sigurimin e përbashkët të mjeteve financiare për ndërtimin e 5 shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, sociale dhe të banimit.

II

Procesi

- Në përputhje me çështjet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, dhe duke iu përmbajtur dispozitave ligjore, palët pajtohen që bashkërisht të promovojnë bashkëpunimin e ndërsjellë në aspektin e profesional, logjistik, financiar dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me Marrëveshje.
- Përzgjedhja e Operatorit punëkryes për ndërtimin e shtëpive ta bëjë Shoqata “Jetimat e Ballkanit” e cila do t’ia dorëzoj Komunës një kopje të Marrëveshjes e cila ndër të tjera përfshinë edhe koston totale të një shtëpie.
- Për pranimin e punëve të kryera Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Shoqatën formon komisionin për pranimin e punëve të kryera.

III

Zotimet e palëve

1. Komuna e Podujevës zotohet:

- Të merr përsipër participimin me mjete financiare në shumë 50,000.00€, për ndërtimin e 5 shtëpive të banimit, përkatësisht 10,000.00€ për secilën shtëpi të ndërtuar.
- Që mjetet e cekura në pikën paraprake do të ndahen nga buxheti i Komunës së Podujevës, dhe do të transferohen në llogarinë bankare të Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” nr.XK051110318280000140 në Pro Credit Bank.
- Që ekzekutimi i pagesës për pjesën e mjeteve financiare që do të ndahen dhe transferohen nga buxheti i Komunës dhe do të realizohet pas fillimit të punimeve.
- Të siguroj kushte të nevojshme për ndërtimin e shtëpive sipas kësaj Marrëveshje duke përfshirë dokumentacionin e nevojshëm në kuadër të autorizimeve që ka si institucion publik.
- Të cakton një zyrtar përgjegjës në cilësinë e organit mbikëqyrës në përcjelljen e realizimit të kësaj Marrëveshje.

2. Shoqata "Jetimat e Ballkanit" zotohet:

- Të merr përsipër ndarjen e mjeteve financiare për bashkëfinancimin e ndërtimit të shtëpive të cekura sipas kësaj Marrëveshje.
- Të dorëzon projektin e detajuar të shtëpive që do të ndërtohen si dhe një kopje të kontratës të lidhur mes Shoqatës dhe punë kryesit për ndërtimin e shtëpive, ndërsa në rast të çfarëdo ndryshimi eventua gjatë ndërtimit të shtëpive e njofton paraprakisht Komunën dhe njëkohësisht kërkon pëlqimin paraprak.
- Që për pjesën e mjeteve financiare që do të ndahen nga buxheti i Komunës së Podujevës, Shoqata do të dërgojë në Komunë deklaratën e kostos financiare për ndërtimin e shtëpive sipas kësaj Marrëveshje.
- Të dorëzon raportin në Komunë, pas ndërtimit çdo shtëpie.
- Të lejoj papenguar të ketë qasje organin mbikëqyrës për përcjelljen e punimeve deri në përfundimin e tërësishëm të ndërtimit të shtëpive.
- Të merr përsipër çdo punë shtesë përfshirë edhe kostot eventuale financiare.

IV

Zotimet e përbashkëta të palëve

Palët pajtohen që:

- Të veprojnë me besim të plotë në arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshje.
- Për çfarëdo ndryshimi, plotësimi apo ndonjë mosmarrëveshje eventuale, të njëjtat t'i zgjidhin me mirëbesim, në formë të shkruar përmes një aneks marrëveshje.
- Përzgjedhjen e familjeve përfituese që do t'iu ndërtohen shtëpitë e banimit ta bëjë një komision i përbashkët i përbërë nga përfaqësuesit e Komunës së Podujevës dhe ata Shoqatës "Jetimat e Ballkanit".

V

Hyrja në fuqi

Marrëveshja nënshkruhet në 4 kopje identike (nga 2 për palët nënshkruese) dhe e njëjta hyn fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

Palët nënshkruese
Podujevë, datë 07 prill 2026

Shpejtim Bulliqi

Kryetar i Komunës së Podujevës



Drejtor i Shoqatës "Jetimat e Ballkanit"